

(/)

KERKO

LAJME - VENDI (/../category/vendi) [FAMILJE \(/../tag/familje\)](#) [MASKA \(/../tag/maska\)](#) [MIRA RAKACOLLI \(/../tag/mira rakacolli\)](#) [ARTAN KONI \(/../tag/Artan Koni\)](#) [VDEKJE \(/../tag/Vdekje\)](#) [TEST \(/../tag/test\)](#) [TEMPORA \(/../tag/tempora\)](#) [QEVERIA \(/../tag/qeveria\)](#) [SHENASI RAMA \(/../tag/Shenasi Rama\)](#)

Selenicë, 47-vjeçari ekzekutohet me 3 plumba në pragun e shtëpisë

Nga: Edi Ruçi

🕒 07/08/2019 - 21:48

RTV Ora - Selenicë, 47-vjeçari ekzekutohet me 3 plumba në pragun e shtëpisë

Një 47 vjeçar i dënuar më parë për trafik droge është vrarë mbrëmjen e sotme (7 gusht 2019) në Selenicë të Vlorës.

Sipas policisë së shtetit viktimë, Nikolla Ikonimi u qëllua me armë të tipit, pistoletë, në pragun e shtëpisë së viktimës, në lagjen "Minatori".

Viktima me dy emra

Ngjarja u mësua rreth orës 21:00 të mbrëmjes së të mërkurës kur në Urgjencën e spitalit të Vlorës mbërriti një telefonatë për një person të gjetur në rrugë dhe që ishte qëlluar me armë.

Viktima njihet nga bashkëfshatarët me emrin Laver Tozaj, ndërsa identiteti i saktë i tij në gjëndjen civile ishte Nikola Ikonimi.

47-vjeçari është qëlluar me 3 plumba

Gazetari i RTV Ora Edi Ruçi raporton se Ikonimi është qëlluar me 3 plumba, një prej të cilave në kokë. Fillimisht ai u gjet i plagosur nga disa kalimtarë, të cilët e transportuan për në spitalin rajonal të Vlorës me një makinë private, por për shkak të plagëve të marra ka ndërruar jetë rrugës. Burime nga policia bëjnë me dije se 47 vjeçari kishte mbërritur i pajetë në spital.

Në spital mbërrijnë edhe familjarët

Gjatë orëve të natës, në ambientet e spitalit të Vlorës ku gjendet viktimë për kryerjes e ekspertizës mjeko ligjore mbërritën edhe familjarët e 47-vjeçarit.

RTV Ora – Vrasja në Selenicë, familjarët e viktimës mbërrijn...**Hakmarrja, pista ku po heton policia**

Pista që po heton policia është ajo e vrasjes për motive të larjes së hesapeve, për shkak edhe të kaluarës së viktimës. Viktima rezultoi të jetë dënuar në 2011 nga Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda me 6 vite e 8 muaj burg për trafik narkotikëve në bashkëpunim. Në 2005 ai ishte arrestuar së bashku me persona të tjerë pasi u sekuestrua në Himarë një sasi prej 335.2 kg kanabis e destinura për tu trafikuar në Greqi përmes detit me skaf.

Asnjë informacion për autorin, në aksion edhe RENEA

Nuk ka ende asnjë informacion për autorin e kësaj vrasje. Ndërkohë në aksion kanë shkuar edhe forcat RENEA, të cilat në bashkëpunim me policinë e shtetit kanë rrethuar vendin e ngjarjes dhe kanë ngritur postblloqe në pikat hyrëse dhe dalëse.

RTV Ora – Selenicë, 47-vjeçari ekzekutohet me 3 plumba në pragun e shtëpisë (Pamje pa ko...